

Pjesëmarrje e detyrueshme e fëmijës suaj në shkollën verore 2026 – Informacion dhe regjistrim

Baza ligjore dhe detyrimi

Pjesëmarrja e fëmijës suaj në shkollën verore bëhet në bazë të dispozitave ligjore për pjesëmarrjen e detyrueshme të nxënësve të jashtëzakonshëm (jo të rregullt). Për këtë arsye, pjesëmarrja është e detyrueshme dhe konsiderohet pjesë e detyrimit shkollor.

Periudha, orari mësimor dhe vendndodhja

Shkolla verore zhvillohet nga data 31. 08. 2026 bis 11. 09. 2026 nga e hëna deri të premten, çdo ditë paradite nga ora 08:00 deri në 12:00. Vendndodhja e caktuar e shkollës verore do të bëhet e ditur në kohë.

Përmbajtja dhe fokusi pedagogjik

Shkolla verore ofron mbështetje të synuar dhe e ndihmon fëmijën tuaj të mësojë gjuhën gjermane dhe ta ushtrojë atë. Mësueset dhe mësuesit, përkatësisht studentët, forcojnë aftësitë gjuhësore dhe të nxënësve në mësim të fëmijës suaj, në mënyrë që ai/ajo të mund të fillojë vitin e ri shkollor i përgatitur mirë dhe me vetëbesim.

Transporti dhe arritshmëria

Ju lutemi të siguroheni që fëmija juaj të vijë në shkollën verore në mënyrë të rregullt dhe në kohë. Informacioni i regjistrimit shërben si biletë udhëtimi për transport publik (autobus, tramvajë, metro dhe tren) ndërmjet vendbanimit tuaj dhe shkollës verore. Nëse nuk ekziston një lidhje e përshtatshme me transport publik ju lutemi ta njoftoni drejtorinë e shkollës. Drejtoria e shkollës do ta përcjellë njoftimin tuaj pranë Drejtorisë së Arsimit, e cila do ta shqyrtojë atë në bazë të dispozitave ligjore për transportin falas të nxënësve me transportin e caktuar nga ata.

Detyrimi i pjesëmarrjes dhe arsyetimet e mungesës

Pjesëmarrja e detyrueshme e ndihmon fëmijën tuaj ta kuptojë më mirë materialin mësimor në vitin e ardhshëm shkollor dhe të jetë i përgatitur mirë. Për këtë arsye, për fëmijën tuaj është detyrim për pjesëmarrje.

Mungesa e pajustifikuar e nxënësve që janë në moshë shkollore konsiderohet shkelje e detyrimit shkollor dhe mund të dënohet nga autoriteti administrativ i rrethit me gjobë deri në 800 €.

Mbrojtja e të dhënave

Të dhënat personale përpunohen ekskluzivisht për qëllime planifikimi, zbatimi dhe dokumentimi, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave.

Deklaroj se jam në dijeni të informacionit të regjistrimit për shkollën verore dhe siguroj pjesëmarrjen e fëmijës tim. Përpunimi i të dhënave të nevojshme për regjistrim bëhet në përputhje me dispozitat e së drejtës shkollore nga Ministria e Arsimit (MBM), Kryeministria (BKA), Drejtoria përkatëse e Arsimit dhe – për atë që është e nevojshme – Administrata Tatimore përkatëse. Jam në dijeni se të dhënat e mia të kontaktit mund të përdoren gjithashtu për dërgimin e një e-maili përkujtues lidhur me shkollën verore.

Me nënshkrimin tim, unë konfirmoj se e kam lexuar dhe e kam kuptuar informacionin.